

## AKTI I THEMELIMIT

&

## STATUTI I SHOQËRISË

“AMAR 2021” SH.P.K

(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, i ndryshuar, u vendos si më poshtë vijon:

### KREU I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA SELIA,

##### Neni 1

##### Data e themelimit dhe emri i shoqërisë

Sot më datë 14.06. 2021, unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AMAR 2021” SH.P.K (në vijim referuar si “Shoqëria”).

Themeluesi i shoqërisë është:

**Z.Ervis Xhafa**, i biri i Fatmirit, shtetas shqiptar, lindur më 12.07.1979, në Durrës, me banim në Shijak, mbajtës i letërnjoftimit me nr.030055535 dhe numër personal: H90712015G, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

##### Neni 2

##### Objekti i veprimitarisë

2.1. Shoqëria ka për objekt të veprimitarisë së saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Veprimtari në fushën e ndërtimit, projektimit, mbikëqyrjes, kolaudimit dhe restaurimit të objekteve civile, industriale, monumentale, kulturore;
- Ndërtime dhe restaurime të të gjitha tipeve përfshirë infrastrukturë rrugore, ura, viadukte, ndërtesa civile, ushtarake, shëndetësore, turistike etj., vepra kullimi, vaditjeje, ujësjellës kanalizime etj., mbrojtje lumore, mbrojtje skarpatesh, porte jahtesh, mini porte detare, heliport, aeroporte etj.
- Studime urbanistike të të gjitha niveleve, projektim arkitektonik, planifikim urban, projektim të strukturave mbajtëse beton-arme, metalike, projektim rrugësh, autostradash, aeroporte, heliportesh;

- Rehabilitim dhe rikonstruksion objekteve të ndryshme me funksion civil shërbimesh dhe/ose banimi si dhe industrial, dhe monumente arkitekture të kategorive të ndryshme;
- Projektim inxhinierik dhe arkitektonik i të gjithë llojeve.
- Prodhim, tregtim, import dhe eksport i materialeve të ndërtimit etj.

2.2. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur ose të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e objektit të saj të aktivitetit, në Shqipëri ose jashtë saj. Në drejtim të përmbushjes së objektit të saj, Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme, ose që kanë të bëjnë me objektin e veprimtarisë, përfshirë por pa u kufizuar në:

-import-eksportin, shitjen dhe blerjen si dhe transportin e mallrave e produkteve të lidhura me objektin e veprimtarisë së saj tregtare;

-ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregti dhe çdo veprim tjetër të lidhur me objektin e veprimtarisë së saj tregtare;

-pjesëmarrje në shoqëri shqiptare apo të huaja, si dhe lidhjen e marrëdhënieve kontraktore apo të bashkëpunimit me palë të treta publike ose private, vendase ose të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta apo të ngjashme.

2.3. Çdo veprim tjetër financiar e tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

### **Neni 4 Selia**

4.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën “Lagjja Kodër, Rruga Qamil Ishmi, Banesa nr. 24 Shijak”, Shijak, Shqipëri. Me vendim të Administratorit selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

### **Neni 5 Të ndryshme**

5.1. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të zmadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërië dhe sipas parashikimeve të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.



**KREU II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË, KALIMI I KUOTAVE,**  
**ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**Neni 6**  
**Kapitali i regjistruar**

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Kapitali i regjistruar është plotësisht i paguar, dhe përbëhet nga një kuotë.

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
ERVIS XHAFA	100 %	1 kuotë

6.2. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 7**  
**Ortakët e shoqërisë**

7.1. Ortakët e Shoqërisë janë personat që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet midis ortakëve në kuota në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributet mund të jenë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve).

**Neni 8**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

8.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve apo rezervave në kapital ose me anë të kontributeve të reja.

8.3. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në para, këto kontribute duhet të nënshkruhen jo më vonë se 30 ditë pasi është vendosur rritja e kapitalit. Këto kontribute duhet të shlyhen plotësisht jo më vonë se 30 ditë pas datës së nënshkrimit. Asambleja e Ortakëve mund të përcaktojë afate të ndryshme në vendimin e zmadhimit të kapitalit.

8.4. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në natyrë, këto kontribute duhet t'i transferohen Shoqërisë përpara regjistrimit në Regjistrin Tregtar. Vlerësimi i kontributeve të reja në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

8.5. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

8.6. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

8.7. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 9**

#### **Fitimi dhe kalimi i kuotave**

9.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

a. kontributet në kapitalin e Shoqërisë;

b. shitblerjes së kuotave;

c. trashëgimisë;

ç. dhurimit;

d. çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

9.2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë janë të transferueshme ndërmjet ortakëve.

9.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çdo i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

### **Neni 10**

#### **Organi vendimarrës**

10.1. Organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

10.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

10.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të përshkruara si më poshtë:

a.përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;

b.ndryshimet e statutit;

c.emërtimin e shkarkimin e administratorit;

- ç. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve për pesonat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

10.4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një procure me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

10.5. Administratori i Shoqërisë mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

10.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

11.1 Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. Ndryshimin e Statutit;
3. Emërimin/shkarkimin e Administratorit, ekspertëve kontabël, likuidatorëve;
4. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët përshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
5. Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
7. Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

8. Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

9. Çështje të tjera që janë të rëndësishme për aktivitetin tregtar të shoqërisë.

11.2. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara të Shoqërisë, të paktën 15 ( pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

11.3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

11.4. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari.

11.5. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

11.6. Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30 % të kapitalit të Shoqërisë, përveçrasteve të parashikuara në nenin 11.7. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme hirret në një mbledhje të dytë Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

11.7. Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë më shumë se 50 % të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

## Neni 12

### Përfaqësimi në Asambleme e Përgjithshme

12.1. Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje, në rastet kur e ka të pamundur pjesëmarrjen personalisht në mbledhje, nga një person i tretë ose edhe nga një ortak tjetër shoqërie. Prokura duhet të ketë të përcaktuar qartë kompetencat e përfaqësuesit si dhe të drejtat e tij lidhur me vendimarrjen në mbledhje.

## KREU IV

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

## Neni 13

### Administrimi



13.1. Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, për një periudhë prej 5 ( pesë ) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet në detyrë ose shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit.

13.2. Administratori gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të cilat ligji dhe ky Statut ja rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë ( nëse ka ).

13.3. Administratori mund të delegojë tek persona të tretë kompetenca specifike lidhur me administrimin e Shoqërisë, deri në kufi të kompetencave që i akordohen atij me këtë Statut, në drejtim të mbarëvajtjes normale të biznesit të Shoqërisë.

13.4. Në çdo rast, Administratori do të jetë përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit në lidhje me administrimin e Shoqërisë.

13.5. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rastin e një konflikti interesi, Administratori njofton menjëherë ortakët dhe nuk do të kryejë asnjë veprim lidhur me objektin e konfliktit të interesit, deri në marrjen e udhëzimeve përkatëse nga Asambleja e Përgjithshme.

13.6. Administratori i Shoqërisë është: z. **Ervis Xhafa**, i biri i Fatmirit, shtetas shqiptar, lindur më 12.07.1979, në Durrës, me banim në Shijak, mbajtës i letërnjoftimit me nr.030055535 dhe numër personal: H90712015G, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Administratori emërohet në detyrë për një periudhë 5 ( pesë ) vjeçare.

#### **Neni 14**

#### **Përfundimi i detyrës dhe shkarkimi i administratorit**

14.1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

a. personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;

b. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;

c. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

d. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë, ose

e. ka munguar pa arsye në detyrë për më shumë se 6 ( gjashtë ) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.



**KREU V**  
**KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË,**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

**Neni 15**  
**Kontrolli Financiar**

15.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**Neni 16**  
**Viti Financiar**

16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

**Neni 17**  
**Bilanci Vjetor**

17.1 Bilanci Vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Këshilli i Administrimit i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

17.2. Dokumentat që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**Neni 18**  
**Dividendi**

18.1. Në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me pjesëmarrjen në kapital të ortakëve.

18.2. Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga të drejtat e lidhura me kuotat, të gjithë dividendët do të deklarohen dhe shpërndahen në përputhje me shumën e paguara për kuotat mbi të cilat shpërndahet dividend.

18.3. Asnjë dividend ose shpërblim tjetër i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk do të mbart interes në dëm të Shoqërisë, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga të drejtat e lidhura me kuotën.



**KREU VI**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**Neni 19**  
**Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

19.1. Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**Neni 20**  
**Ligji i zbatueshëm**

20.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**Neni 21**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

21.1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve të tjerë dhe/ose të Shoqërisë, në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti Themelimi e Statuti, do të zgjidhen miqësisht e drejtpërdrejt ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 22**  
**Gjuha**

22.1. Ky Akt Themelimi dhe Statut nënshkruhet në 3 kopje të njejta në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar më datë 14.06.2021.

**ORTAKU I VETËM**  
**ERVIS KHAFI**